



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

PROJEKTI FITUES ME TITULL:

**“ZHVILLIMI I INFRASTRUKTURËS NË SHËRBBIM
TË FUQIZIMIT TË KËRKUESËVE TË RINJ
DHE TË STUDENTËVE”**

**FINANCUAR NGA MINISTERIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
NË KUADËR TË NDËRKOMBËTARIZIMIT TË PROGRAMEVE TË STUDIMIT PËR
VITIN AKADEMIK 2022-2023**



Ekipi i projektit:

Prof. Dr. Esmeralda KROMIDHA (koordinatore)

Prof. Asoc. Dr. Anida KISI

Prof. Asoc. Dr. Ogerta KORUTI

Prof. Asoc. Dr. Etleva KONDI

Dr. Elvana SHTËPANI

Aktivitet mbi realizimin e punës në fazën e parë:

NGRITJA E INFRASTRUKTURËS KËRKIMORE-SHKENCORE



Më 14 shkurt të vitit 2023, u organizua aktiviteti mbi zhvillimet infrastrukturore të realizuara në projektin fitues në kuadër të thirrjes së hapur për projekte nga Ministria e Arsimit dhe Sportit në qershor 2022, për zhvillimin e infrastrukturës akademike, didaktike dhe kërkimore.

Në këtë aktivitet morën pjesë: Ministrija e Arsimit dhe Sportit, Rektori i UT-së me përfaqësues të tjerë të lartë të rektoratit, anëtarë të Dekanatit të FGJH-së sëbashku me personelin akademik e administrativ të fakultetit, ku u zhvillua ceremonia e përrimit të laboratorëve të mësimdhënies dhe të kërkimit, të realizuar me financimin e dy projekteve fituese të FGJH-së.

Në ceremoni u vu theksi tek rëndësia e këtyre projekteve infrastrukturore në shërbim të zhvillimit të kapaciteteve të infrastrukturës akademike, didaktike dhe kërkimore, të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit duke mundësuar realizimin e hulumtimeve dhe punëve kërkimore me standarde të larta, impaktit të drejtpërdrejtë që do të kenë këto investime teknologjike në kuadër të ndërkombëtarizimit të programeve të studimit, inovacionit pedagogjik në mësimdhënie, rrjetëzimit të kërkuesve shkencorë vendas e të huaj duke realizuar takime, tryeza apo konferenca të përbashkëta.

Rektori i Universitetit të Tiranës, Prof. Dr. Artan HOXHA shprehu falënderimet për punën e kryer nga FGJH si edhe mbështetjen e vazhdueshme për të përkrahur nismat e FGJH-së në drejtim të digjitalizimit dhe ndërkombëtarizimit të programeve studimore.

Ministrja e Arsimit dhe Sportit, Zj. Evis KUSHI përgëzoi Dekanen dhe Rektoren për arritjet e deritanishme si edhe u shpreh se mbështetja e MAS-it për IAL-të në drejtim të financimit të projekteve infrastrukturore dhe zhvillimore do të vijë gjithnjë e në rritje duke u mbështetur edhe në një dialog të vazhdueshëm për zgjidhjen e çështjeve të ndryshme që lidhen me arsimin e lartë.

Më poshtë foto të aktivitetit për përrurimin e laboratorëve të rinj:





Realizimit të suksesshëm të këtij projekti iu dha një zë i veçantë në publikimet e bëra nga vetë Kryeministri i Shqipërisë z. Edi RAMA dhe nga Ministria e Arsimit dhe Sportit znj. Evis KUSHI.

link:

<https://www.facebook.com/FAKULTETIiGJUHEVEteHUAJAIUT/posts/pfbid02ywF5h7FLEMjrNVmbZaKSK9TaSkW5VPZQoxShiBRAXCbFJ7ki4WhAhq2dy3XYobkel>

link:

<https://www.facebook.com/FAKULTETIiGJUHEVEteHUAJAIUT/posts/pfbid0rYV8Gf4JtFXC1DX3RoWtRs6cbS2cUGJfb7aPHC8CsLKgYXv1ETBmsuV9xKnD3CDil>

Ky aktivitet u pasqyrua gjithashtu në web zyrtar dhe rrjetet sociale të Universitetit të Tiranës dhe Fakultetit të Gjuhëve të Huaja.

Link:

<https://www.facebook.com/FAKULTETIiGJUHEVEteHUAJAIUT/posts/pfbid0KQ9ggXjyehxPmuLASjr8hrscmUhvQPUgsaRCs47z84CpVPFYxZTG5o6USUMvChjWl>